

# Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA)

...një proces i mirë planifikimi çon në vlerësim më të mirë të parave për shpenzimet publike...

**Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është elementi thelbësor i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI).** Procesi i përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) udhëhiqet nga Ministria e Financave dhe kërkon nga çdo ministri hartimin e një plani 3-vjeçar brenda një tavani të caktuar shpenzimesh për arritjen e objektivave politike në program si një hap i ndërmjetëm drejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave të SKZHI-së dhe strategjive sektoriale dhe ndër-sektoriale. Qëllimi është të sigurohet një lidhje e qartë mes shpërndarjes së buxhetit dhe objektivave politike në program, duke arritur parashikueshmëri dhe efikasitet më të lartë në shpërndarjen e burimeve.

**Hollësitë e procedurave të PBA-së janë përcaktuar disa vite më parë.** Kalendarit të PBA-së është pjesë përbërëse e kalendarit të përgjithshëm të SPI-së. Vendosja e PBA-së nën ombrellën e SPI-së transformoi të gjithë filozofinë nga një buxhet i bazuar në burime (input) në një buxhet të bazuar në rezultate (output) dhe performancë.

**Procesi i përgatitjes së PBA-së u përmirësua në mënyrë domethënëse duke filluar nga viti 2008** përpara i përket disiplinës krahasuar me kalendarin e SPI-së dhe cilësisë së paraqitjes. Të gjitha ministritë e linjës paraqesin kërkesat e tyre në kohë dhe në një cilësi shumë më të lartë. Udhëheqja dhe mbikëqyrja nga Ministria e Financave bënë ndryshimin gjatë gjithë procesit. DEBASKON-i udhëheq Rishikimin e Politikës së Programit duke siguruar që kërkesat e PBA-së nga ministritë e linjës të jenë në përputhje të plotë me strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale dhe me objektivat politike të SKZHI-së në tërësi.

**Procedura të reja mbi Menaxhimin e Investimeve Publike (MIP)** u adoptuan si pjesë përbërëse e procedurave të PBA-së duke filluar nga viti 2008. Procedurat e reja MIP imponojnë një cikël të detyrueshëm në përgatitjen e projekteve që kërkon analiza të hollësishme dhe vlerësime të projekteve të investimit nga ana e ministrive përpara kërkesës së tyre për financim. Procedurat gjatë gjithë ciklit të investimeve lidhen ngushtë me programin dhe rishikimin e politikave, si dhe me fazat e planifikimit strategjik të ciklit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike.

**Procedurat e PBA-së mbështeten nga sistemi i PBA-së i cili operon përmes sistemit “të rrjetit qeveritar” (GovNet).** Lidhja midis sistemit të PBA-së dhe atij të Thesarit mbetet një sfidë e së ardhmes. Sistemi i Informacionit për Sistemin e Planifikimit të Integruar (SISPI) pritet të krijojë disa lehtësira në këtë aspekt si dhe të çojë në një përmirësim të sistemeve të monitorimit të SKZHI-së dhe PBA-së.

Në Korrik 2008 u miratua nga Parlamenti Ligji i ri për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Ky Ligj siguron një kuadër ligjor inkurajues për një menaxhim cilësor të shpenzimeve publike.

Sistemi i PBA-së monitoron, çdo tremujor, performancën ekonomike dhe fiskale të vendit.

Një vlerësim vjetor (në çdo fund viti) është i detyrueshëm për çdo ministri linje, përpara përfundimit të tremujorit të parë të vitit të ri.

Duke pasur parasysh zbatimin e procedurave të reja për Menaxhimin e Investimeve Publike, duke inkurajuar ministritë e linjës të konsolidojnë portofolet e tyre të investimeve, numri i projekteve të investimeve në buxhetin vjetor ka pësuar rënie nga 1860 projekte në vitin 2006 në më pak se 900 projekte në vitin 2009.